



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 299, datë 13.07.2021

PËR

PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS TË KANDIDATIT PËR KËSHILLTAR LIGJOR Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 90 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikat 18 dhe 25, seksioni C, kreu IV të vendimit të KLGJ nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, znj. Brikena Ukperaj,

VENDOSI:

1. Pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për këshilltar ligjor z. {...}, të filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 497 datë 21.10.2020, deri në përfundimin me vendim të formës së prerë të procedurës së verifikimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...} dhe Gjykatës së Lartë.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për këshilltar ligjor, z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR